

EU 4 CIRCULAR ECONOMY AND LIVABLE CITIES



Implemented by



UDHËZUES PËR APLIKANTËT PËR GRANTE

Nr. referencës për thirrjen: E-81317209

Ky udhëzues për aplikantët për grante përcakton rregullat për aplikimin dhe dorëzimin e projekt propozimeve, përzgjedhjen dhe zbatimin e projekteve që financohen nëpërmjet kësaj thirrjeje, në përputhje me rregullat e projektit “*Mëso të rivlerësosh. Mos shpërdoro! – Zhvillojmë modele të ekonomisë qarkulluese me përgjigjshmëri gjinore*”, i cili mbështetet financiarisht nga projekti “*Bashkimi Evropian për Ekonomi Qarkulluese dhe Qytete të Jetueshme*”. Ky projekt bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian dhe Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), dhe zbatohet nga GIZ Albania në partneritet me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.




Zbatohet nga:



PËRMBAJTJA

1. SFONDI I THIRRJES	3
2. PËRKUFIZIME TË RËNDËSISHME	3
3. OBJEKTIVAT E THIRRJES	4
4. SHTRIRJA GJEOGRAFIKE	4
5. MBESHTETJA FINANCIARE.....	4
6. KRITERET E APLIKIMIT	4
6.1 Kush mund të aplikojë?	4
6.2 Kush nuk mund të aplikojë?	5
Individët, partitë politike, organizatat ndërkombëtare dhe të huaja, si dhe institucionet qeveritare nuk mund të marrin pjesë në këtë thirrje për grante.	5
6.3 Kriteret për aplikantët.....	5
6.4 Bashkë-aplikantët dhe partnerët e asociuar	5
7. KRITERET PËR PROJEKT PROPOZIMET	5
7.1 Sektorët dhe tematikat.....	5
7.2 Kategoritë e aktiviteteve që mbështëten nga kjo thirrje	6
7.3 Aktivitete që nuk mbulohen nga kjo thirrje	6
7.4 Komponenti i përgjigjshmërisë gjinore në ekonominë qarkulluese (gender responsive circular economy)	6
7.4 Kostot e pranueshme.....	8
8. APLIKIMI DHE DOREZIMI	9
8.1 Paketa e dokumentave që duhet të dorëzohen.....	9
8.2 Dorëzimi i aplikimit	10
9. VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E APLIKIMEVE.....	10
9.1 Faza 1: Hapja dhe kontrolli administrativ i projekt propozimeve.....	10
9.2 Faza 2: Vlerësimi i projekt propozimeve	12
10. NJOFTIMI I FITUESVE.....	14
11. VIZIBILITETI	15
12. KALENDARI INDIKATIV I PROCESIT	15
13. LISTA E ANEKSEVE.....	16



1. SFONDI I THIRRJES

Frymëzuar nga proverbi që edukon njerëzit të përdorin me mençuri burimet dhe të shmangin shpërdorimin, projekti *“Mëso të rivlerësosh. Mos shpërdoro! – Zhvillojmë modele të ekonomisë qarkulluese me përgjigjshmëri gjinore”* synon të mbështesë nisma inovative të ekonomisë qarkulluese me përgjigjshmëri gjinore në Shqipëri.

Ndërsa Shqipëria po bën përparime drejt zhvillimit të qëndrueshëm, ekzistojnë ende disa sfida kyçe: menaxhimi i mbetjeve mbetet i dobët, çështjet gjinore rrallëherë përfshihen në programet mjedisore, dhe shumë njerëz nuk kanë njohuritë apo mjetet e nevojshme për të krijuar zgjidhje me parimet e ekonomisë qarkulluese. Gjithashtu, aksesimi i financimeve është shpesh i vështirë për shkak të rregullave të ndërlikuara dhe mungesës së informacionit.

Kjo thirrje për grante synon të adresojë këto boshllëqe duke ofruar mbështetje financiare, duke promovuar pjesëmarrjen e barabartë dhe duke nxjerrë mësim të cilat mund të ndihmojnë në përsëritjen e praktikave të mira në të ardhmen dhe ndikimin në politikat përkatëse. Ajo synon të ndërthurë qëndrueshmërinë me barazinë gjinore në një mënyrë praktike dhe të përshtatur me kontekstin kulturor, duke kontribuar në ndërtimin e një të ardhmeje që zbaton parimet e ekonomisë qarkulluese dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë.

Dhënia e granteve të vogla për zbatimin e nismave nga aktorët lokalë në Shqipëri do të mundësojë realizimin e projekteve të rëndësishme për komunitetet vendore – në veçanti për gratë, të rinjtë dhe grupet e marginalizuara (si gratë nga komuniteti rom) – për të hartuar dhe zbatuar projekte të ekonomisë qarkulluese, si dhe për të forcuar kapacitetet e tyre në këtë fushë.

Përmes një mekanizmi transparent dhe konkurrues financimi, kjo thirrje përbën një mundësi të artë për aktorët lokalë në Shqipëri – veçanërisht gratë, të rinjtë dhe grupet e marginalizuara – për të zhvilluar dhe zbatuar projekte të ekonomisë qarkulluese.

2. PËRKUFIZIME TË RËNDËSISHME


Përkufizimet e mëposhtme ndihmojnë të ndërtojnë botëkuptimin e njëjtë mbi konceptet dhe fokusin e hartimit të projekt propozimeve për këtë thirrje.

Ekonomia qarkulluese synon të ruajë vlerën e produkteve, materialeve dhe burimeve për aq kohë sa të jetë e mundur. Prandaj, ajo ofron një alternativë që është në kontrast të drejtpërdrejtë me modelin aktual ekonomik linear, në të cilin produktet prodhohen me shpenzime të konsiderueshme dhe më pas hidhen pas një periudhe të shkurtër përdorimi. Në një model qarkullues, produktet dhe materialet janë projektuar që në fillim për t'u ripërdorur, riparuar dhe më vonë për t'u ripërdorur ose ricikluar në mënyrë efikase, duke kursyer kështu burimet dhe duke zvogëluar mbetjet. Në të njëjtën kohë, krijohen modele të reja biznesi dhe vende pune.

Përgjigjshmëria gjinore nënkupton njohjen, trajtimin dhe adresimin aktiv të dallimeve gjinore në role, nevoja, mundësi dhe përvoja, me qëllim **promovimin e barazisë gjinore** në të gjitha fushat e politikave, programeve dhe praktikave institucionale apo shoqërore.

Më poshtë janë dy përkufizime teknike mbi ekonominë qarkulluese me përgjigjshmëri gjinore të cilat plotësojnë njëra – tjetrën dhe kanë qëllim të udhëzojnë hartimin e projekteve tuaja:

Ekonomia qarkulluese me përgjigjshmëri gjinore nënkupton një sistem ekonomik që synon të minimizojë mbetjet dhe të shfrytëzojë burimet sa më shumë (përmes ripërdorimit, riparimit,



rinovimit dhe riciklimit), duke siguruar njëkohësisht mundësi, përfitime dhe fuqi vendimmarrëse të barabarta për të gjitha gjinitë. Kjo përfshin identifikimin dhe adresimin proaktiv të ndikimeve, sfidave dhe kontributeve të ndryshme të grave, burrave dhe njerëzve me larmi gjinore në të gjithë zinxhirin e vlerës së burimeve.

Ekonomia qarkulluese me përgjigjshmëri gjinore në praktikë nënkupton procesin e hartimit, zbatimit dhe përshkallëzimit të strategjive të ekonomisë qarkulluese (të tilla si zgjatja e jetëgjatësisë së produktit, zinxhirët e furnizimit me qark të mbyllur dhe riciklimi i materialeve) në një mënyrë që promovon fuqizimin e grave, nxit pjesëmarrjen e barabartë dhe mbyll boshllëqet gjinore në burimet financiare, aftësitë dhe në leadership.

3. OBJEKTIVAT E THIRRJES

Qëllimi i përgjithshëm i kësaj thirrjeje për grante është të mbështesë nisma inovative dhe të shkallëzueshme që ndërthurin parimet e ekonomisë qarkulluese me përgjigjshmëri gjinore.

Qëllimet specifike:

1. Të mbështesë zhvillimin dhe zbatimin e zgjidhjeve të ekonomisë qarkulluese me përgjigjshmëri gjinore, të cilat promovojnë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve dhe reduktimin e mbetjeve, duke siguruar një pjesëmarrje të barabartë ekonomike.
2. Të forcojë kapacitetet e komuniteteve, bizneseve dhe organizatave për të adoptuar, zbatuar dhe përshkallëzuar modele të ekonomisë qarkulluese me përgjigjshmëri gjinore, për qëndrueshmëri dhe ndikim afatgjatë.

4. SHTRIRJA GJEORAFIKE

Aktivitetet e projekteve duhet të zbatohen në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nxiten, pa synim preferencial, aktorët që punojnë dhe kanë aktivitet në: Shkodër, Kukës, Lezhë, Vau i Dejës, Cërrik, Gramsh, Belsh, Himarë, Sarandë, Gjirokastrë, Pogradec, Prrenjas, Përmet, Këlcyrë, Tepelenë.

5. MBESHTETJA FINANCIARE

Shuma totale e alokuar për ndarjen e nëngranteve: 100,000 EUR

Shuma maksimale e mbështetjes financiare për nëngrant është 20,000 EUR.

Kohëzgjatja e projektit është 4 muaj të plotë, as më shumë dhe as më pak.

Parashikimi i investimeve nuk është kriter detyrues dhe mos parashikimi i tyre nuk është kriter penalizues. **Bashkëfinancimi nuk është kriter detyrues në këtë thirrje për aplikim.**

6. KRITERET E APLIKIMIT

6.1 Kush mund të aplikojë?

Në këtë thirrje mund të aplikojnë:

- Organizatat jo fitimprurëse (OJF) dhe “grassroots” të regjistruara në përputhje me legjislacionin ekzistues në Shqipëri,

- Universitetet dhe qendrat kërkimore,
- Ndërmarrjet mikro, të Vogla dhe të Mesme (NVM)

6.2 Kush nuk mund të aplikojë?

Individët, partitë politike, organizatat ndërkombëtare dhe të huaja, si dhe institucionet qeveritare nuk mund të marrin pjesë në këtë thirrje për grante.

6.3 Kriteret për aplikantët

Aplikantët duhet:

- Të jenë të regjistruar sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë
- Të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Shqipërisë
- Të jenë përgjegjës të drejtpërdrejtë për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit
- Të jenë regjistruar 2 vite përpara afatit të aplikimit në këtë thirrje
- Të kenë ekipe pune/staf të përbërë prej 3-25 anëtarë
- Të punojnë në fushat e veprimit të kësaj thirrje (shih më poshtë)
- Në rastin e NVM-ve, nuk duhet të kenë përfituar nga skema grantesh/ mbështetje nga donatorë në dy vitet e fundit

Një aplikant mund të dorëzojë më shumë se një aplikim me kushtin që çdo aplikim i dorëzuar duhet të trajtojë një problematikë të veçantë. Nuk lejohet dorëzimi i disa aplikimeve me përmbajtje të ngjashme apo që synojnë të zgjidhin të njëjtin problem. Për aplikantët të cilët dorëzojnë më shumë se një aplikim lejohet që vetëm një prej tyre të përfitojë nga skema e granteve.

6.4 Bashkë-aplikantët dhe partnerët e asociuar

Në këtë thirrje partneriteti i një aplikanti me aplikantë të tjerë nuk është i detyrueshëm. Në këtë thirrje nxitet, në rast se aplikanti e konsideron vlerë të shtuar, partneriteti pa buxhet (asocimi) me institucionet e pushtetit vendor dhe njësitë e formës së partneritetit publik privat, por edhe organizata të tjera. Në këtë rast aplikanti duhet të sigurojë një letër mbështetëse që të përmbajë të dhënat, shprehjen e interesit dhe mbështetjen e partnerit të asociuar.


7. KRITERET PËR PROJEKT PROPOZIMET

7.1 Sektorët dhe tematikat

Projektet duhet të kontribuojnë drejtpërdrejt në (I) ekonominë qarkulluese, (II) përfshirjen sociale dhe barazinë gjinore, dhe (III) fuqizimin e të rinjve dhe grupeve të marginalizuara.

Temat prioritare përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Zgjidhje për zvogëlimin ose ripërdorimin e rrymave të ndryshme të mbetjeve;
- Modele biznesi që krijojnë vende pune të gjelbërta për gra dhe grupe të marginalizuara;
- Inovacion digjital (aplikacione, platforma, analiza të dhënash) i cili lehtëson ekonominë qarkulluese;
- Nisma që përfshijnë komunitete rome/egjiptiane, persona me aftësi të kufizuara ose banorë të zonave rurale në zinxhirin e vlerave qarkulluese.
- Ngritje kapacitesh (trajnime profesionale dhe makerspaces), me fokus pjesëmarrjen e barabartë të grave; (ne raste të tilla duhet shmangur “one-off events” dhe në përgjithësi duhen konceptuar ndërhyrje me ndikim real.)



7.2 Kategoritë e aktiviteteve që mbështëten nga kjo thirrje

Kjo thirrje mbështet tre kategori kryesore aktiviteteve dhe lista nuk është shteruese:

- 1) Zgjidhje praktike të ekonomisë qarkulluese (p.sh. riparim tekstilësh, kompostim, refill station etj.);
- 2) Fuqizim socio-ekonomik me fokus barazinë gjinore (trajnime, workshope, krijim vendesh pune për gra & grupe të marginalizuara etj.);
- 3) Inovacion dhe ndërgjegjësim (hackathon, platforma digjitale, fushata edukative, etj.).

Çdo projekt duhet të adresojë të paktën njëren kategori. Projektet që ndërthurin dy ose më shumë kategori marrin pikë shtesë. Për të garantuar përputhjen me objektivat gjinore dhe gjithëpërfshirjen, propozimet duhet të përfshijnë indikatorë të matshëm.


7.3 Aktivitete që nuk mbulohen nga kjo thirrje

Projektet që përmbajnë aktivitete të renditur në listën e mëposhtme nuk janë të pranueshme për t'u mbuluar kjo thirrje:

- aktivitete që mbartin rreziqe shtesë që mund të dëmtojnë shëndetin, gratë, ose mjedisin (p.sh. aktivitete që përforcojnë stereotipe gjinore ose krijojnë ekspozim të rrezikshëm fizik në punë);
- aktivitete që nuk tregojnë se si gratë, të rinjtë apo grupet e marginalizuara do të përfitojnë në mënyrë të qëndrueshme;
- aktivitete që nxisin punë të papaguar ose shpërndarje të padrejtë të të ardhurave ndërmjet gjinive;
- aktivitete që bien ndesh me parimet e ekonomisë qarkulluese (p.sh. fokus tek incinerimi pa rikuperim material)
- veprimtari që lidhen vetëm ose kryesisht me sponsorizime individuale për pjesëmarrje në workshope, seminare, konferenca dhe kongrese;
- veprimtari që lidhen vetëm ose kryesisht me bursa individuale për studime apo trajnime;
- veprimtari që lidhen vetëm ose kryesisht me një konferencë të vetme dhe ngjarje të ngjashme;
- veprimtari që lidhen vetëm ose kryesisht me kërkime akademike pa përmbajtje dhe/ose studime fizibiliteti;
- veprimtari që lidhen vetëm ose kryesisht me investime në infrastrukturë dhe/ose blerje pajisjesh;
- aktivitete që shpenzojnë më shumë se 40% të grantit për pajisje/infrastrukturë/furnizime pa një plan trajnimi dhe mirëmbajtjeje;
- veprimtari të lidhura me parti politike ose me natyrë politike/partizane;
- veprimtari që kanë të bëjnë me ndihma emergjente ose dhurime bamirësie;
- veprimtari që bien brenda funksioneve të përgjithshme të institucioneve shtetërore kompetente ose shërbimeve të administratës shtetërore, përfshirë pushtetin vendor;
- veprimtari që lidhen me: industrinë e duhanit (kodi CAEN 16), prodhimin e pijeve alkoolike të distiluara (kodi CAEN 1591), armë dhe municione (kodi CAEN 296).

7.4 Komponenti i përgjigjshmërisë gjinore në ekonominë qarkulluese (gender responsive circular economy)

Projektet që do mbështeten nga kjo thirrje duhet të integrojnë parimet e ekonomisë qarkulluese me përgjigjshmërinë gjinore. Për këtë arsye, një kriter shumë i rëndësishëm i projekteve është që të tregojnë një lidhje të qartë midis zgjidhjeve të ekonomisë qarkulluese dhe përgjigjshmërisë gjinore.



Për të ndihmuar integrimin e komponentit të përgjegjshmërisë gjinore në projekt idetë tuaja dhe për të matur arritjet, ju vjen në ndihmë formati i analizës gjinore i cilë është pjesë e kornizës logjike të paketës së aplikimit.

Në të njëjtën kohë, për të kontrolluar zhvillimin e idesë suaj, nëse ajo e përfshin përgjegjshmërinë gjinore në çdo element të saj, mund të ndiqni udhëzimet e mëposhtme:

Fusha	Kontrolli për elementin e përgjegjshmërisë gjinore	Pse ndihmon
Analiza gjinore	Rolet dhe nevojat e grave përgjatë zinxhirit qarkullues ose në zgjidhjen e propozuar në koncept (dizajn → konsum → riparim → riciklim).	Siguron që projekti bazohet në evidenca reale dhe shmang “gender-washing”.
Objektiva SMART	Objektivat e projektit tuaj adresojnë në mënyrë Specifike, të Matshme, të Arritshme, të mbështetura në Rezultat, dhe brenda afatit Kohor çështjet e përgjishmërisë gjinore si: <i>punësimi i grave, rritja e kapaciteteve të grave, mbështetja e nismave të udhëhequra nga gratë etj.</i>	Lehtëson matjen e ndikimit brenda afatit 4-mujor.
Tregues gjinor	Tregues cilësor dhe sasior që tregojnë qartësisht zhvillimin e gruas. <i>Psh: % gra/vajza në pozicione vendimmarrëse; nr. i vendeve të punës së krijuara për gratë; kg mbetje të shmangura falë nismave/praktikave të drejtuara nga gra etj.</i>	Harmonizim me kriteret e vlerësimit që tashmë kërkojnë “ndikim” mbi grupet përfituese.
Struktura e ekipit	Ekipi i projektit të ketë balancë gjinore	Reflekton objektivat kryesore të thirrjes.

Shembuj jo shterues të aktiviteteve që integrojnë përgjegjshmërinë gjinore me ekonominë qarkulluese, të hasura edhe në vendin tonë, janë:

- Zhvillimi i programeve të mentorimit dhe lidërshiptit për gratë sipërmarrëse në sektorët e gjelbër dhe inovativ, ose inkubatorë për biznese të drejtuara nga gratë dhe të rinjtë në fushat e produkteve të qëndrueshme, tekstileve të ricikluara apo paketimit të gjelbër
- Zgjidhje që lidhin edukimin STEAM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri, Arte dhe Matematikë) me ekonominë qarkulluese, me një fokus të veçantë tek vajzat dhe gratë në zonat rurale
- Platforma komunitare për ndarjen dhe ripërdorimin e burimeve, që promovojnë solidaritetin social dhe konsumimin e përgjegjshëm
- Nisma të lidhura me turizmin e qëndrueshëm dhe traditat lokale, duke përfshirë gra në prodhimin e produkteve ekologjike ose artizanale nga materiale të riciklueshme
- Programe që integrojnë shërbimet sociale me praktikatat e ekonomisë qarkulluese

- Fushata edukative për promovimin e konsumit të përgjegjshëm, reduktimit të mbetjeve dhe rolit të grave në tranzicionin e gjelbër
- Programe edukative në shkolla, që ndërthurin ndërgjegjësimin për barazinë gjinore me ekonominë qarkulluese dhe sjelljet e qëndrueshme
- Nisma të arteve dhe kulturës (si teatri, arti publik, dokumentarët), që vënë në pah rolin e komuniteteve të marginalizuara dhe të grave në ruajtjen e burimeve dhe në praktikën e ekonomisë qarkulluese

7.4 Kostot e pranueshme

Vetëm "Kostot e pranueshme" mund të konsiderohen për mbështetje financiare nga kjo thirrje grantesh. Kategoritë e kostove të konsideruara si të pranueshme dhe jo të pranueshme listohen më poshtë. *Kujdes!* Kostot e pranueshme duhet të bazohen në vlera reale kostosh referuar në dokumentet mbështetëse.

Aplikantët e përzgjedhur për një grant gjithmonë i nënshtrohen një procesi kontrolli buxhetor para nënshkrimit të kontratës. Ky proces ka për qëllim të nxjerrë në pah probleme dhe çështje që kërkojnë ndryshime në buxhet (për shembull gabime aritmetike, pasaktësi ose kosto jo reale dhe kosto të tjera të papranueshme). Prandaj, është në interesin e aplikantëve të paraqesin një buxhet realist dhe me kosto efektive.

7.4.1 Kriteret për kostot e lejuara

Të gjitha kostot e parashikuara në buxhetin e projektit duhet të përmbushin të gjitha kriteret e mëposhtme:

- ato janë kryer gjatë periudhës së zbatimit të grantit;
- ato janë në përputhje me kategoritë e linjave të buxhetit sipas formatit buxhetor;
- ato janë të nevojshme për zbatimin e projekt propozimit që është objekt i grantit;
- ato janë të identifikueshme, të verifikueshme dhe të dokumentuara (p.sh. kontratë, faturë, urdhërpagesë etj.), në veçanti duke u regjistruar në regjistrat kontabël të përfituesit të grantit dhe të përcaktuara sipas standardeve të zbatueshme të kontabilitetit;
- ato përputhen me kërkesat e legjislacionit të tatim taksave dhe sigurimeve shoqërore në Shqipëri;
- ato janë të arsyeshme, të justifikuar dhe përputhen me parimin e menaxhimit të shëndoshë financiar, në veçanti në lidhje me ekonominë dhe efikasitetin;
- ato janë të kryera në përputhje me legjislacionin kombëtar shqiptar;
- ato nuk janë të listuara në listën e kostove jo të pranueshme më poshtë;

7.4.2 Kostot e drejtpërdrejta të pranueshme

- Kostot e stafit të caktuar për zbatimin e projektit, që korrespondojnë me pagat bruto aktuale, duke përfshirë tarifat e sigurimeve shoqërore dhe kostot e tjera që lidhen me shpërblimet.
- Shpenzimet e udhëtimeve dhe dietave për personelin dhe personat e tjerë që marrin pjesë në projekt, me kusht që të jenë kosto reale të konfirmuara nga dokumente mbështetëse;
- Kostot e blerjeve për pajisje (të reja ose të përdorura) dhe shërbime të posaçme për qëllimet e projektit;
- Kostot e shpenzimeve të zyrave dhe furnizimeve me materiale të konsumueshme të dedikuara posaçërisht për qëllimet e projektit (vetëm për organizatat jo fitimprurëse);

- Kostot e drejtpërdrejta të zbatimit të aktiviteteve si shërbime, vizibilitet, aksione etj, për qëllimet e projektit;

7.4.3 Kostot e papranueshme

- Detyrimet doganore;
- Borxhet dhe tarifat e shërbimit të borxhit (interesi);
- Dispozitat për humbjet ose detyrimet e mundshme në të ardhmen;
- Kostot e deklaruara nga përfituesi dhe të financuara nga një projekt ose program tjetër;
- Blerja e tokës ose ndërtesave;
- Blerja e automjeteve dhe telefonave celularë. Kosto të tilla mund të merren në konsideratë për pranim vetëm nëse janë thelbësore për zbatimin e projektit;
- Humbjet nga këmbimi valutor;
- Kostot e garancisë bankare ose çdo garanci tjetër;
- Kredia për palët e treta;
- Gjobat, penalitetet financiare dhe shpenzimet për mosmarrëveshjet ligjore;
- Kostot e qirasë për njësitë që nuk janë organizata jo fitimprurëse;
- Kostot e pagave të personelit të administratës shtetërore, publike;
- Produktet ose shërbimet që i përkasin sektorëve specifikë që nuk janë të pranueshme në përputhje me praktikat e BE-së (prodhimi i alkoolit, duhani, lojërat e fatit, ushtria);
- Tarifa e regjistrimit të biznesit.

8. APLIKIMI DHE DOREZIMI

Projekt propozimet duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe, duke respektuar udhëzimet e shpjeguara në këtë dokument dhe vetëm duke përdorur formatet e paketës së aplikimit për këtë thirrje.

8.1 Paketa e dokumentave që duhet të dorëzohen

1) Paketa e aplikimit, e cila përmban:


- Formën e aplikimit (Aneksi I)
- Formën e buxhetit (Aneksi II)
- Matricën e kuadrit logjik (Aneksi III)

2) Dokumentat mbështetëse të cilat janë:

Për OJF-të dhe grassroots:

1. Vendim i regjistrimit në gjykatë (kopje e skanuar);
2. Statuti dhe Akti i Themelimit të organizatës (kopje e skanuar);
3. Regjistrimi në zyrën e tatim taksave (NIPT) (kopje e skanuar)
4. Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve që tregon se organizata është aktive dhe nuk ka detyrime të pashlyera tatimore
5. Pasqyrat financiare të 2 viteve të fundit (2024, 2023)
6. CV e organizatës në të cilën del në pah eksperiencia e organizatës në tre vitet e fundit;
7. Marrëveshja e partneritetit me partnerin/ët e asociuar (nese ka) (kopje e skanuar)

Për universitetet dhe qendrat e kërkimit:

- 
1. Vendim ose Akt Themelimi nga autoriteti kompetent (p.sh. VKM për institucionet publike ose licenca nga MAS për institucionet private) (kopje);
 2. Statuti ose Rregullorja e brendshme e institucionit (kopje e skanuar);
 3. NIPT-i i institucionit (kopje e skanuar);
 4. CV institucionale – përshkrim i përvojës dhe aktiviteteve relevante në 3 vitet e fundit;
 5. Marrëveshje e partneritetit me partnerin/ët e asociuar (nese ka) (kopje e skanuar)

Për NVM-të:

1. Ekstrakti i QKB-së (Qendra Kombëtare e Biznesit) (kopje e skanuar)
2. Statuti dhe/ose Akti i Themelimit të shoqërisë – (nëse është i aplikueshëm për formën juridike të shoqërisë);
3. Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve që tregon se NVM-ja është aktive dhe nuk ka detyrime të pashlyera tatimore
4. Pasqyrat financiare të 2 viteve të fundit (2024, 2023)
5. Marrëveshje e partneritetit me partnerin/ët e asociuar (nese ka) (kopje e skanuar)

Kujdes! Nëse dokumentet e lartpërmendura nuk dorëzohen së bashku me paketën e aplikimit, projekt propozimi mund të refuzohet. Dokumentat mbështetëse duhen bashkuar dhe duhen ngarkuar si një dokument i vetëm në .pdf.

8.2 Dorëzimi i aplikimit

Paketa e aplikimit së bashku me dokumentat shoqëruese do të dorëzohet online në platformën g-drive më poshtë:

<https://forms.gle/mi7vCkPuEu6hV9mu5>

Afati për dorëzimin e aplikimit është **27 Korrik 2025, ora 23:59**.

Pas këtij afati sistemi i aplikimit do të mbyllet dhe ju nuk do keni mundësinë të dorëzoni aplikimin tuaj.

Kujdes! Për të shmangur ngarkesën e sistemit në ditët e fundit ju këshillojmë të ngarkoni aplikimin paraprakisht, sepse nëse ju nuk jeni në gjendje të aplikoni për shkak të ngarkesës së sistemit, kjo përgjegjësi është e juaja.

9. VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E APLIKIMEVE

Një Komision Vlerësimi i dedikuar do të ngrihet dhe anëtarët e tij do të kenë mandatin për të siguruar një vlerësim objektiv, të paanshëm dhe profesional ndaj projekt propozimeve të dorëzuara.

Vlerësimi është planifikuar të kalojë në 2 faza:

9.1 Faza 1: Hapja dhe kontrolli administrativ i projekt propozimeve

Gjatë hapjes dhe kontrollit administrativ të aplikimeve, do të kontrollohet nëse paketa e aplikimit i plotëson të gjitha kriteret e pranueshmërisë dhe dokumentacionin e kërkuar në këtë udhëzues.


Nëse ndonjë nga informacionet e kërkuara mungon ose është i pasaktë, aplikimi *mund të refuzohet* vetëm mbi këtë bazë dhe nuk do të vlerësohet më tej.

Nëse vërtetohet se aplikanti dhe projekt propozimi nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë të listuara në këtë udhëzues, aplikimi *mund të refuzohet* vetëm mbi këtë bazë.

Procesi i vlerësimit do të vazhdojë vetëm për aplikantët të cilët kalojnë këtë fazë vlerësimi.

Kriteret që do të kontrollohen në këtë fazë janë:

Kriteret administrative	Po	Jo	Komente
Aplikanti ka respektuar formatet e kërkuar të aplikimit			
Aplikanti ka respektuar gjuhën e kërkuar të aplikimit			
Aplikanti përmbush kriteret e pranueshmërisë			
Dokumentat mbështetës	Po	Jo	Komente
<i>Për OJF-të dhe grassroots</i>			
Vendim i regjistrimit në gjykatë (kopje e skanuar);			
Statuti dhe Akti i Themelimit të organizatës (kopje e skanuar);			
Regjistrimi në zyrën e tatim taksave (NIPT) (kopje e skanuar)			
Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve që tregon se organizata është aktive dhe nuk ka detyrime të pashlyera tatimore			
Pasqyrat financiare të 2 viteve të fundit (2024, 2023)			
CV e organizatës në të cilën del në pah eksperiencia e organizatës në tre vitet e fundit;			
Marrëveshje e partneritetit me partnerin/ët e asociuar (nese ka) (kopje e skanuar)			
<i>Për universitetet dhe qendrat e kërkimit</i>			
Vendim ose Akt Themelimi nga autoriteti kompetent (p.sh. VKM për institucionet publike ose licenca nga MAS për institucionet private) (kopje);			
Statuti ose Rregullorja e brendshme e institucionit – (kopje e skanuar)			
NIPT-i i institucionit (kopje e skanuar)			
CV institucionale			
Marrëveshje e partneritetit me partnerin/ët e asociuar (nese ka) (kopje e skanuar)			
<i>Për NVM-të</i>			
Ekstrakti i QKB-së (Qendra Kombëtare e Biznesit) (kopje e skanuar)			
Statuti dhe/ose Akti i Themelimit të shoqërisë – (nëse është i aplikueshëm për formën juridike të shoqërisë);			
Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve që tregon se NVM-ja është aktive dhe nuk ka detyrime të pashlyera tatimore			




Pasqyrat financiare të 2 viteve të fundit (2024, 2023)			
Marrëveshje e partneritetit me partnerin/ët e asociuar (nese ka) (kopje e skanuar)			
Buxheti, kohëzgjatja, rr. aplikimeve	Po	Jo	Komente
Buxheti i kërkuar nga kjo thirrje është brenda limiteve të kërkuara			
Kohëzgjatja e projektit është 4 muaj			
Aplikuesi ka paraqitur një aplikim			
Aplikuesi ka paraqitur më shumë se 1 aplikim			
(Në rast të shumë aplikimeve) Aplikimet nuk trajtojnë të njëjtat problematika			

9.2 Faza 2: Vlerësimi i projekt propozimeve

Cilësia e projekt propozimeve, duke përfshirë buxhetin e propozuar dhe kapacitetin e aplikuesve, do të vlerësohet duke përdorur kriteret e vlerësimit të listuar në tabelën më poshtë:

Kriteret	Shpjegimi	Pikët
1. Përputhshmëria me objektivat e thirrjes	Përputhshmëria me qëllimet e përgjithshme dhe specifike të thirrjes. Përputhshmëria me parimet e ekonomisë qarkulluese dhe përgjigjshmërinë gjinore. Përputhshmëria me prioritetet tematike: reduktimi i mbetjeve, punësimi gjithëpërfshirës, inovacioni, zhvillimi i kapaciteteve, etj.	15
2. Inovacioni	Originaliteti i përjasjes ose zgjidhjes së propozuar. Përdorimi i modeleve, teknologjive ose praktikave gjithëpërfshirëse të reja. Dallimi nga nismat ekzistuese në atë fushëveprim.	10
3. Realizueshmëria dhe koherenca	Realizimi i objektivave dhe aktiviteteve brenda afatit kohor prej 4 muajsh. Qartësia dhe logjika e metodologjisë/strategjisë. Përkufizimi i qartë i roleve, përgjegjësisë dhe afatit kohor.	15

4. Qëndrueshmëria dhe përshkallëzimi	Mundësia që përfitimet dhe rezultatet të vazhdojnë edhe pas përfundimit të projektit. Mundësia për përsëritje të nismës ose përshkallëzim i saj nga aktorë të tjerë. Përdorimi i burimeve vendore, partneriteteve dhe ngritja e pronësisë komunitare.	10
5. Barazia gjinore dhe gjithëpërfshirja	Dëshmi për kryerjen ose integrimin e analizës gjinore në projekt propozim. Ekzistojnë aktivitete të hartuara posaçërisht për të reduktuar hendekët gjinorë (p.sh., trajnime të targetuara për gratë, skema punësimi për gra/të rinj/grupe të marzhinalizuara etj.)? Përdorimi i treguesve dhe të dhënave gjinore. Projekti përfshin grupe të marginalizuara (p.sh., gratë rome, gratë me aftësi të kufizuara, gratë në zonat rurale, të rinjtë jo të punësuar). Përfshirja e komuniteteve lokale. Aktivitetet e propozuara përputhen me nevojat që adresohen nga gratë/vajzat dhe komunitetet e marginalizuara në drejtim të përgjigshmërisë gjinore dhe qasjes gjithëpërfshirëse të aplikantit në projekt propozim. Integrimi ndërsektorial – propozimi trajton në mënyrë kuptimplotë më shumë se një kategori ndërhyrjeje (p.sh., kombinon inovacion digjital + zhvillim kapacitetesh + punësim për gratë). Ideja përmirëson barazinë gjinore dhe përfshirjen e përfituesve/të komunitetit të synuar.	20
6. Ndikimi mjedisor dhe social	Redukton drejtpërdrejt mbetjet ose ndotjen (p.sh., tekstile, plastikë, ushqim). Promovon ripërdorimin, riparimin, riciklimin, kompostimin ose konsum të qëndrueshëm. Promovon punë të sigurt, me dinjitet dhe domethënëse për grate, të rinjtë dhe grupet e marginalizuara.	15



	Ndërhyrjet e propozuara janë në përputhje me parimet e ekonomisë qarkulluese	
7. Efektiviteti i kostove dhe justifikimi i buxhetit	Shpërdarje e qartë e buxhetit dhe një lidhje e qartë me aktivitetet. Kostot janë të arsyeshme dhe përputhen me çmimet e tregut. Ka një balancë logjike të shpërndarjes së kostove midis stafit, aktiviteteve dhe pajisjeve.	15
Vlerësimi total		100

Pas vlerësimit, aplikimet do të renditen sipas pikëve të tyre nga më i larti tek më i ulëti. Aplikimet me pikët më të larta do të përzgjidhen përkohësisht derisa të arrihet buxheti i disponueshëm. Në rast kursimesh, fondet e mbetura mund të përdoren për të financuar grante shtesë sipas pikëve të tyre.

Në rast të aplikimeve me pikë të barabarta (balotazh) ose të aplikimeve me diferencë me presje dhjetore midis aplikantëve, do të zhvillohet një dëgjese me kandidatët potencial përpara Komisionit të Vlerësimit, të cilët më pas do të japin edhe vendimin përfundimtar.

Lista e projekteve fituese të granteve do të publikohet në faqen e internetit të EDEN.

10. NJOFTIMI I FITUESVE

10.1 Procesi i njoftimit

Aplikantët do të njoftohen me shkrim për vendimin e Autoritetit Kontraktor në lidhje me rezultatet e projekt propozimeve të tyre. Aplikantët do të marrin përmes e-mailit një letër komunikimi të skanuar. Të gjithë aplikantët do të njoftohen për rezultatet, dhe në rastet kur aplikimi i tyre refuzohet, njoftimi do të shoqërohet me arsyet e vendimarrjes negative dhe nga tabela e pikëzimit.

Aplikantët të cilët besojnë se janë vlerësuar negativisht si rezultat i ndonjë gabimi apo parregullsie gjatë procesit të vlerësimit, mund të ankohen me shkrim, brenda 5 (pesë) ditëve (ditë pune) nga dita që kanë marrë njoftim për refuzim. Të gjitha ankesat do të shqyrtohen dhe përgjigja do të kthehet brenda 5 ditëve (ditë pune) nga paraqitja e ankesës.

10.2 Kushtet e zbatimit

Pas vendimit për dhënien e një granti, secilit aplikant të përzgjedhur do t'i ofrohet një kontratë e cila do të zyrtarizojë marrëdhëniet midis palëve. Me nënshkrimin e Kontratës së Grantit, aplikantët pranojnë kushtet kontraktuale. Në rast nevojë, sqarimi i buxhetit mund të bëhet para nënshkrimit të kontratës.

Gjithashtu, para nënshkrimit të Kontratës së Grantit, aplikantët, projekt propozimet e të cilëve janë përzgjedhur përkohësisht, do të duhet të dorëzojnë përmbledhjen e projekteve të tyre në anglisht dhe buxhetin në formatin anglisht.

Kontratat e Grantit do të nënshkruhen në shqip.

11. VIZIBILITETI

Aplikantët duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të bërë publike faktin që projekti i zbatuar nga GIZ Albania, EU 4 Circular Economy and Livable Cities (EU4CELC) ka financuar projektin. Projektet që financohen plotësisht ose pjesërisht nga (EU4CELC) duhet të përfshijnë aktivitete informimi dhe komunikimi për të rritur ndërgjegjësimin e audiencave specifike ose të përgjithshme mbi objektivat e projektit dhe mbështetjen e ofruar nga EU4CELC, si dhe rezultatet dhe ndikimin e kësaj mbështetjeje.

Aplikantët duhet të respektojnë qëllimet dhe prioritetet dhe të garantojnë vizibilitetin për suportin e ofruar nga projekti EU4CELC (Për më shumë informacion shihni Manualin e Komunikimit dhe Vizibilitetit).

Aplikantët njoftohen t'i kushtojnë vëmendje të veçantë komunikimit, vizibilitetit dhe marrëdhënieve me mediat duke respektuar rregullat e listuara në Manualin e komunikimit.

12. KALENDARI INDIKATIV I PROCESIT

Kalendari i procesit të aplikimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së granteve jepet në mënyrë indikative në tabelën e mëposhtme:

Procesi	Data	Ora
Shpallja publike e thirrjes për grante	27.06.2025	16:00
Sesioni i informimit 1 (fizik)	01.07.2025	09:30
Sesioni i informimit 2 (online)	08.07.2025	10:00
Sesioni i informimit 3 (online)	11.07.2025	10:00
Publikimi i sqarimeve nga Autoriteti Kontraktues	11.07.2025	17:00
Afati i fundit për t'i drejtuar pyetje sqaruese Autoritetit Kontraktues	18.07.2025	17:00
Afati i fundit për dorëzimin e Aplikimeve	27.07.2025	23:59
Kontrolli administrativ i aplikimeve	30.07.2025	17:00
Vlerësimi i projekt propozimeve nga Komisioni i Vlerësimit	01.08.2025	17:00
Njoftimi i aplikanteve për rezultatin e vlerësimit*	04.08.2025	17:00
Afati i fundit për ankimim	08.08.2025	17:00
Kthim përgjigje për ankimimet	15.08.2025	17:00
Firmosja e kontrates*	18.08.2025	17:00

**Datat mund te ndryshojnë përgjatë procedurës së thirrjes për grante*

13. LISTA E ANEKSEVE

Aneksi I: Formati i aplikimit

Aneksi II: Formati i buxhetit

Aneksi III: Matrica e kornizës logjike